



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-35130 /22

Klinë,dt: 12, 10 /22

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 12.09.2022, me fillim nga ora 9:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtorët dhe të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Draft- buxhetit 2023-2025 për Komunën e Klinës (ref. Drejt. Fin.),
4. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetarë i mbajtur nga kryetari i Komunës,
5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin korrik-gusht 2022,
6. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Meqë është takimi i parë pas pushimeve, unë besoj që keni kaluar mirë, po i falënderoj anëtarët e këtij Komiteti për Politikë dhe Financa, zyrtarët e Policisë që janë bashkë me ne, udhëheqësen e zyrës për Komunitete, Silvija Rashkoviq, ushtruesin e detyrës së drejtorit, Ajet Sejdiu dhe drejtorin e Urbanizmit, Enver Berisha.

Po besoj që materialin e keni marr bashkë me ftesë dhe konfirmoj se Tunë Deda nuk do të jetë në këtë takim për shkak të udhëtimit në Zvicër, mungon edhe anëtarja, Valmira Krasniqi, por ne mund të procedojmë sepse jemi pesë anëtarë të Komitetit. A ka dikush për rend të ditës? Nëse

s'ka, kush është për miratimin e rendit të ditës?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsytimi i mungesave.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë vetëm sa e konfirmova për Tunë Dedën, për Valmira Krasniqin nuk e kam ndonjë informacion.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Fadil Gashi, Kryesues: Nëse ka dikush prej anëtarëve të KPF-së për procesverbalin e seancës së kaluar, urdhëroni! Kush është për miratim të procesit?

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 5 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Draft- buxhetit 2023-2025 për Komunën e Klinës (ref. Drejt. Fin.).

Fadil Gashi, Kryesues: Fillimisht po e lus ushtruesin e detyrës së drejtorit, z.Ajet Sejdiun që të na paraqes në pika të shkurtra. Besoj që ju materialin e keni dhe po ju lus, sot nuk përfundon këtu gjithçka që ne e debatojmë, edhe nesër e kemi prapë në këtë sallë Debatin me Publikun, në ora 10:00, kemi ftuar grupe të interesit, biznese dhe kategori të ndryshme. Ky është dokumenti më i rëndësishëm pas Statusit të Komunës, por gjithsesi edhe nesër kemi debat edhe do vazhdojë prapë, dhe ju si anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, gjitha komitetet tjera edhe ata që janë jashtë vendit, jashtë ekzekutivit, ende kanë mundësi që t'i shprehin kërkesat e tyre dhe sa më shumë që të marrim vërejtje, sugjerime edhe propozime unë besoj që e pasurojmë edhe draftin dhe vetë buxhetin e Komunës.

Ajet Sejdiu: Faleminderit i nderuar Kryetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, përshëndetje për punëtorët e policisë së Kosovës dhe ju të pranishëm! Siç e tha kryetari i Kuvendit, sot kemi para vetes një ndër draftet më të rëndësishme pas Statusit të Komunës dhe shumë akteve tjera ligjore dhe nënligjore, sepse ky dokument përcakton kahjen edhe zhvillimin ekonomik e shoqëror të komunës së Klinës për periudhën një vjeçare dhe parashikimet për vitin 2024-2025. Drejtoria e Financave bashkë me ekzekutivin, menjëherë pas marrjes së qarkores buxhetore 01\2023 ju ka qasur punës, detyrave përkatëse të përcaktuara sipas statutit, por në këtë vit e kemi bërë një ndryshim në zgjedhjen e një komisioni sipas rregullores për dëgjime publike, e kemi

bërë zgjedhjen e komisionit prej ekspertëve potencial, financiar dhe ekonomik, për zhvillimin e këtij procesi shumë të rëndësishëm, kemi zgjedhur komisionin i cili prej ditës së parë ka përgatitur njoftimin për të gjithë faktorët relevant për zhvillimin e procesit të buxhetit, e në atë njoftim janë përfshirë të gjitha hapat të cilat duhet m'i ndërmarrë të gjithë faktorët relevant në përpilimin e buxhetit. E kemi përpiluar buxhetin në aspektin profesional dhe ja kemi dërguar ekzekutivit, pas ekzekutivit e kemi vënë në diskutim publik, së pari Kornizën afatmesme-buxhetore dhe i kemi njoftuar të gjitha fshatrat, bashkësitë lokale për dëgjimet publike por e kemi bërë orarin dhe e kemi zhvilluar procesin e dëgjimeve publike që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin dhe procesimin e buxhetit të mëtutjeshëm. Pas aprovimit me 30 qershor të Kornizës afatmesme buxhetore, kemi përgatitur buxhetin strikt pas marrjes së qarkores 02\2023 qarkores së Ministrisë së Financave, e cila ka përcaktuar kufijtë strikt të zhvillimit dhe kufijtë për të gjitha kategoritë buxhetore duke përfshirë prej kapitalit që janë më të rëndësishme, mallra dhe shërbime, subvencione dhe komunalit. Në këtë proces prapë kemi zhvilluar dëgjime me publikun ku kanë buruar edhe në Kornizën afatmesme buxhetore që është aprovuar nga ky Kuvend dhe nga ky Komunitet por edhe buxhetin që e kemi përgatitur në vija të sakta, sepse qarkorja e dytë buxhetore i ka përcaktuar kufijtë e saktë të buxhetit për vitin 2023. Siç e shihni, e kemi draftin përpara, kemi një rritje jo fort të madhe të buxhetit në tërësi diku për 8.57% kurse kemi edhe rritje të hyrave vetanake, çka për vitin 2023 unë mendoj që është një hendikep për komunën sepse është rritur për 380 mijë euro më shumë sesa në vitin që jemi tani. Pra, kemi rritje edhe të hyrave që ne duhet t'i realizojmë të hyrat vetanake prej taksave dhe tatimeve të komunës, ne, këtë buxhet prej 8.57% që është rritur nga grandet edhe në shëndetësi edhe në arsim, jemi të hendikepuar se ku do t'i shpërndajmë. Ne i kemi shpërndarë ashtu siç janë kërkesat e qytetarëve që kanë buruar nga dëgjimet publike, i kemi shpërndarë ashtu siç i keni ju sot përpara.

Është me rëndësi se dy kategori buxhetore i kemi rritur në këtë periudhë, janë: të hyrat vetanake, kapitalet dhe subvencionet, të cilat kapitalet janë orientuar më shumë për shkak të projekteve që kanë buruar nga propozimet në dëgjimet publike, do të thotë për kapitale kemi diku 4 milion e 50 mijë euro në këtë vit për t'i realizuar për kapitale për projektet që i kemi marr prej qytetarëve dhe prej faktorëve tjerë relevant, 70% i kemi marr prej bashkësive lokale dhe fshatrave që kanë propozuar drejtpërdrejtë projekte dhe ato projekte i kemi inkorporuar drejtpërdrejt në materialin që e keni ju sot përpara. Është me rëndësi që edhe nesër, siç e potencoi kryetari me dhanë ndonjë propozim që është shumë i qëlluar, që mund ta inkorporojmë prapë në projekte dhe shpresoj që edhe nesër ta kemi një publik sikurse i kemi pasur në bashkësitë lokale dhe me i dhanë propozimet e veta gjithsecili. Ne jemi të hapur që ato propozime t'i inkorporojmë, për momentin kaq kryetar, faleminderit!

Fadil Gashi: Faleminderit, unë po hap debat për anëtarët e Komitetit por edhe të tjerët nëse jeni të interesuar, urdhëro znj. Mendehie Duraku!

Mendehie Duraku: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Unë drejtorin e dëgjova me vëmendje, desha ta pyes aty ku tha që kemi biseduar me disa ekspertë, a jeni këshilluar me ata apo e keni hartuar së bashku draft-buxhetin edhe desha të di ata ekspertë a janë zyrtarë publik apo janë nga jashtë?

Ajet Sejdiu: Udhëzimi Administrativ thotë që me u zgjedh ekspert i Drejtorisë së Financave, por është komision që është zgjedhur nga ekzekutivi, nga ZKA-ja (zyrtari kryesor administrativ), në

krye të atij komisioni është ZKF-ja, (zyrtarja kryesore financiare), Xufe Kelmendi e cila bashkë me atë komision e ka përgatitur buxhetin. Ne kemi qenë në kontakt të përhershëm me të po Udhëzimi Administrativ e përcakton nga Drejtoria e Financave.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, a ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që raporti i dëgjimeve publike të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetarë i mbajtur nga kryetari i Komunës.

Fadil Gashi, Kryesues: Kush është për ta rekomanduar në Kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetarë i mbajtur nga kryetari i Komunës, të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin korrik-gusht 2022.

Kërkesa 1

- Kërkesë e parashtruar nga znj. Sevdije Ismaili, e cila thekson se jeton në një gjendje të rëndë ekonomike dhe vuan nga një sëmundje e rënd ALS-Neuron Motorik, sëmundje e cila vazhdimisht duhet të trajtohet me terapi dhe vizita të vazhdueshme tek specialistët. Andaj si ish-punonjëse e Komunës së Klinës kërkon ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve, pasi që është barrë përballimi i shpenzimeve nga ekonomia familjare, thekson parashtruesja e kërkesës!

Fadil Gashi, Kryesues: Sevdijen e keni kolege ju dhe unë, unë po e di se asnjëri nga ne nuk është që i thotë jo kësaj dhe meqë ju pajtoheni ne e rekomandojmë për Kuvend. Deri në Kuvend ndoshta edhe ekzekutivi bashkë me kryetarin për afërsisht mund të na determinojnë deri në sa mund të shkojnë. Nuk ka ndonjë kërkesë me duket specifike në vlerësim, në vlerë, në shumë por diagnozën dhe sëmundjen i keni te paraqitura aty. A ka dikush, kush është për?

-Pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Sevdije Ismaili, Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Kuvend dhe Kuvendi në koordinim me Ekzekutivin të vendosin për shumën me të cilën mund ta ndihmojnë.

Kërkesa 2

-Kërkesë e parashtruar nga z. Gjokë Gjoni, i cili kërkon që t'i jepet në shfrytëzim për ekonomi familjare, parcela me nr. P-710011065-00016-1 në sipërfaqe prej 4222 m2 pronë e Komunës së Klinës, e cila gjendet afër shtëpisë së tij në fshatin Deiq.

Fadil Gashi, Kryesues: Për dhënie në shfrytëzim të hapësirave publike ne nuk mundemi sepse duhet filluar me listën që është e shpallur dhe listë të shpallur nuk kemi për këtë vit. Unë po shpresoj që deri me 31 dhjetor qysh është obligim kërkesë ligjore që duhet kryetari i komunës me na sjell listën për vitin vijues edhe pastaj duke e parë cilat janë ato hapësira që ne vërtet mund t'i japim në shfrytëzim. Me keqardhje po them se ne s'kemi mundur ende asnjë pëllëmbë të ja japim dikujt në shfrytëzim për shkak të këtyre mangësive që jemi të hendikepuar. A po pajtoheni, kush është për?

-Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që kjo kërkesë të kalojë për shqyrtim në Zyrën e kryetarit dhe në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, të kompletohet si lëndë duke respektuar Ligjin Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe pastaj të vijë në Kuvend.

Kërkesa 3.

- Kërkesë e parashtruar nga familja Krasniqi, për lejimin e shfrytëzimit të një pjese të tokës në sipërfaqe prej 1 m² afër pllakës përkujtimore të martirëve në Klinë, për vendosjen e portretit të vajzës së tyre të ndjerë Shpresa Krasniqit, e torturuar dhe e masakruar në fshatin Lugbunar të komunës së Gjakovës me 12.04.1999.

Fadil Gashi, Kryesues: Është një rast i ndjeshëm por ne duhet të marrim vendim ligjor, vendim që respekton procedurat, por që nuk lëndon as familjen.

Ne edhe me shërbimin i kemi nxjerr gjithë emrat që janë të gdhendur aty në lapidarin që janë "Martirët e Zhdukur", nuk është emri i saj, nuk e di si ka ndodhur, por nuk është!

Por që e di se është rast i ndjeshëm edhe se është për ta trajtuar dhe respektuar nuk e ka asnjë dilemë, por si me e gjet mënyrën edhe me ndihmu edhe mos me lëndu asnjë procedurë, mos me lëndu dhe me i qetësu edhe familjarët tjerë, se atëherë mund të thonë se pse një bust po bën dhe një tjetër nuk bën. Edhe ne kemi shumë shtiza që na drejtohen, prandaj ne si institucion duhet me qenë në nivel mos me pranuar asnjë shtizë karshi neve, por duke u drejtuar me respektin dhe seriozitetin më të madh secilin rast veç e veç por edhe grupor qashtu qysh është, ndoshta më së miri kishte me qenë me lënë njëherë pa përgjigje këtë pjesë, për me mujt e me konsultu me institucionet dhe individët që mund të kenë qasje në zgjidhjen e kësaj çështje dhe me pa ndonjë alternativë, qoftë te hapësira, qoftë te vendosja, qoftë te trajtimi, por e do një vëmendje pak më serioze kjo kërkesë.

Ju e dini, ne e kemi marr një vendim në Dresnik për me u vendos një bust edhe na u ka kthyer prej ministrisë. Prandaj veç le ta fillon rrugën dhe të shohim në proces si mund ta procedojmë pastaj. Unë kisha thënë që si Komitet gjithsesi me e rekomanduar për Kuvend, por gjithsesi në rekomandime tona ta përfshijmë edhe kryetarin e komunës edhe drejtorin që e kemi prezent,

edhe familjen, me qenë angazhimi i të gjithëve, çka mund të bëhet dhe si mund të procedohet. Unë po hap debat, a ka dikush?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e parashtruar nga familja Krasniqi, të trajtohet në mënyrë meritore nga të gjitha institucionet. Me këtë rast, Ekzekutivi, Kuvendi, Familja dhe Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, në koordinim të plotë me njëra-tjetrën, të gjejnë një zgjidhje për këtë çështje, pastaj të merret vendim.

Kërkesa 4.

- Kërkesë e parashtruar nga z. Bardhec Laci nga fshati Dobërdol, Komuna Klinë, i cili thekson se menjëherë pas lufte ka ndërtuar një stallë në një sipërfaqe përafërsisht prej 200 m² në njësinë kadastrale me Nr. P- 71010020-00448-0, e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej 169013 m² vendi i quajtur Fusha e Canës, e cila është e regjistruar pronë e Komunës së Klinës. Stalla është ndërtuar duke menduar që po ndërtohet në pronën e tij ngase prona e tij përkufizohet me pronën komunale. Po ashtu thekson se prona e cila tash figuron në emër të Komunës së Klinës, më herët ka qenë pronë e paraardhësve të tyre meqë edhe emërtimin e ka Fusha e Canës. Cana ka qenë katragjyshi i tyre. Më vonë e ka kuptuar që vendi ku ka ndërtuar stallën është pronë e Komunës së Klinës dhe jo pronë e tij private. Me këtë rast interesi për dhënien në shfrytëzim i pronës do të ishte i ndërsjellë në mes të Familjes Laci dhe Komunës së Klinës.

Fadil Gashi, Kryesues: Po besoj se edhe kjo e ka rrugën ashtu si ajo më lart, a ka dikush? Kush është për rekomandim që kjo kërkesë duhet t'i plotësojë kërkesat ligjore sikur ajo më lart?

-Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që kjo kërkesë të kalojë për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, të kompletohet si lëndë duke respektuar Ligjin Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe pastaj të vijë në Kuvend.

Kërkesa 5. Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe MM për inicim të procedurave të këmbimit të pronave me interes publik, për ndërtimin e rrugës në zonën e Dresnikut. Parcelën P-71010027-01731-1 Zk. Dresnik me pronar Y. M. me parcelën P-71010027-02146-0 ZK. Dresnik pronë e komunës së Klinës. Sipas kërkesës së pronarit Y. M., në bazë të incizimit gjeodezik, jep 455 metra katror nga parcela P-71010027-01731-1 Zk. Dresnik Komuna Klinë pronë e tij dhe merr 328 metra katror nga parcela P-71010027-02146-0 ZK. Dresnik Komuna Klinë, pronë e Komunës së Klinës.

-Arsyetim: Komuna e Klinës është duke e realizuar projektin asfaltimi i rrugës Dresnik-Dollc , dhe në trasenë e rrugës së planifikuar, do të punohet rruga e cila kalon në pjesë të parcelave të sipërpërmendura dhe njëkohësisht kësaj kërkesë i bashkëngjitet ekspertiza me matje gjeodezike të pjesës së parcelës që kërkohet për këmbim, mirëpo do të këtë edhe matje nga ana e kadastrës

në nivel komune.

Fadil Gashi, Kryesues: Kjo ka ardhur nga Drejtoria e Urbanizmit, kërkesë për t'u këmbyer prona e komunës me pronë private, kjo është natyrë tash tjetër, nuk është dhënie në shfrytëzim por këmbim edhe ne sot marrim vendim veç me fillu procedurat, me u inicju procedurat dhe procedurat pastaj sipas ligjit zhvillohen prej ekzekutivit. Urdhëro drejtor, Enver Berisha!

Enver Berisha: Përshëndetje kryetar, përshëndetje anëtarë të KPF-së. Sa për informim, po ju tregoj pak në detaje, në bazë të Ligjit të inicimit të procedurave të këmbimit të pronave në interes publik, këtu kemi kërkesa të qytetarëve të cilat kanë shprehur mendim dhe kanë vullnet që ta ndërrojnë pronën publike me atë private aty ku është në vijë të parcelës së njëjtë se përndryshe në qoftë se kalojmë në parcelë atëherë nuk na lejon ligji mirëpo e kemi parë bazën ligjore dhe është e mundshme që përmes procedurave të Kuvendit të iniciohet dhe pastaj të kalohet në kërkesa tjera, kështu që ne i kemi dy kërkesa: Njëra kërkesë është e iniciuar kurse tjetra ka mangësi diçka derisa të kompletohet dokumentacioni, fjala është për rrugën Dollc-Dresnik që është në implementim e sipër. Faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit drejtor, dikush tjetër? Pra, bëhet fjalë veç me fillu me inicju procedurën, veç me u inicju procedura e këmbimit, pastaj si bëhet dhe si vlerësohet janë ekipet tjera dhe më duket është i veçantë ai që bën vlerësimin e pronave, edhe tonën edhe pjesën private ose i ka disa procedura tjera. A ka dikush?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së iniciuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe MM, për këmbim të pronës Komunale me atë private në interes të Komunës së Klinës, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Kuvend dhe të merret vendim për shpallje zonë me interes publik, pastaj të zhvillohen procedurat për këmbim të pronës sipas Ligjit Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa 6. Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe MM për inicim të procedurave të këmbimit të pronave me interes publik për ndërtimin e rrugës në zonën e Dresnikut. Parcelën P-71010027-00080-4 Zonë kadastrale Dresnikë, komuna Klinë, me pronar kontratë shitblerje Blerësi N. G. shitësi D. R. meqenëse parcelat janë të të njëjtës klasë dhe zonë kërkohet se sa metra katror i merr traseja e rrugës aq metër katror t'i jepet në këmbim.

Arsyetim: Komuna e Klinës është duke e realizuar projektin e asfaltimit të rrugës Dresnik-Dollc, dhe në trasenë e rrugës së planifikuar, do të punohet rruga e cila kalon në pjesën e parcelës të sipërpërmendur, dhe njëkohësisht kësaj kërkesë i bashkëngjitet ekspertiza me matje gjeodezike të pjesës së parcelës që kërkohet për shpronësim, mirëpo do të këtë edhe matje nga ana e kadastrës në nivel komune.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju nuk e keni këtë kërkesë, nuk jua kanë shpërndarë sepse nuk është

komplet dhe meqë s'është komplet ne po e kthejmë mbrapa, le ta kompletojnë Drejtorja dhe kushdo tjetër dhe pastaj ta sjellin. A ka dikush?

-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me 5 vota PËR, konstatoi se kërkesa nuk i plotëson kushtet për të vazhduar më tutje me procedura për këmbim të pronës, pasi që nuk është e kompletuar si lëndë, andaj si e tillë refuzohet deri në kompletimin e lëndës.

Pika 6. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush tek të ndryshmet? Nëse s'ka, unë po ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

